

NR:04/2018

Nr.prot:63/18 Lenda nr.62418030521

<b>Për:</b>	NNSH EMSA, Suharekë
<b>Kopje:</b>	z.Bali Muharremaj, Kryetar Komuna Suharekë
<b>Nga:</b>	Bujar Kuçi, shef i Zyrës së Prokurimit
<b>Lënda:</b>	VENDIM për kërkesën për rishqyrtim të datës: 09/09/2018 nga OE NNSH EMSA
<b>Datë:</b>	12/09/2018

I nderuar z.Sopa,

Autoriteti Kontraktues Komuna Suharekë ka **MIRATUAR** kërkesën për rishqyrtim të datës 09/09/2018 të pranuar në kopje elektronike në adresën zyrtare të AK Komuna Suharekë (me datë 10.09.2018), për projektin: "Ndertimi i kanalizimit (segmente) në lagjen Sopa, Graishta dhe Lugu në Duhel" me nr prokurimit: **624 18 030 521**.  
 Kërkesa është miratuar si e bazuar konform nenit 108/A pika 10.2 të LPP-së.

**Arësytet:**


1. Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesën e OE NNSH EMSA, dhe me qëllim të evitimit të shkeljeve të mundshme të LPP-së (deke marr parasysh interpretimin e KRPP-se lidhur me referencën negative për të cilin është eliminuar OE EMSA), për këtë lëndë do të vepronte konform "Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave", neni 8 pika 8.1.2.i, duke kthyer lenden në rivlersim.

Interpretimi i KRPP-se për referencën negative:

Ndërsa sa i përket pyetjes lidhur me Referencë Negative, sipas nenit 65 i LPP nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, paragrafi 4, thuhet se, citojmë: Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik ; **4.7" gjatë tri viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë njësi publike, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë ose diku tjetër".** Andaj, nga e gjithë ajo që cek më lartë, KRPP, konsideron se, për ta përjashtuar një Operator Ekonomik nga pjesëmarrja në një aktivitet prokurimi apo nga ekzekutimi i kontratës, nuk mund të bëhet vetëm me referencë negative të AK) pa e konstatuar nga një Gjykatë kompetente, si që përcaktohet sipas LPP neni 65 paragrafi 4.7.

Të gjithë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit do të njoftohen për rezultatet e rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Shef i Zyres së Prokurimit Komuna Suhareke  
 Bujar Kuçi



Adresa: rr.Brigada 123, p.n 23000 Suharekë